


njoftim për prindër:
Lajmërim i shqetësimit tek shërbimi social



Lajmërim i shqetësimit tek shërbimi social

Nëse personeli shëndetësor shqetësohet se një fëmijë është duke hequr keq ose nëse fëmija apo familja kanë nevojë për ndihmë e mbështetje nga shërbimi social, atëherë personeli shëndetësor është i obliguar menjëherë të lajmëroj shër-bimin social sipas ligjit të shërbimit social, nen. 14 parag. 1. Ky lajmërim synon që të hetohet nëse Ti si prind apo kujdestar fëmije ke nevojë për ndihmë në rolin e prindit.

Një lajmërim në shërbimin social bazohet gjithmonë në shqetësimin për fëmijun.

Ky lajmërim varet nga shqetësimi se fëmijës nuk i jepet ajo që ka nevojë, p.sh mungesa e kujdesit dhe e mbikqyrjes për shkak të vështirësive të prindërve, mangësive sa i përketë ushqimit, higjenës, ilaçeve apo kujdesit të dhëmbëve, ose nëse fëmija keqtrajtohet fizikisht apo psiqikisht apo abuzohet seksualisht.

Pavarësisht se është bërë lajmërimi, fëmija yt dhe Ti keni të drejtë në mjekim dhe pritje të mirë.

Në kuadër të përkujdesjes shëndetësore në Rajonin Skåne ka këshilltar social që mund të jenë një mbështetje e mirë nëse keni pyetje rreth lajmërimit të bërë në shërbimin social. Lute personelin e repartit apo ordincancën që t'ju ndihmoj të kontaktoni këshilltarin social.

Nëse lajmërimi bëhet kur fëmija është duke u mjekuar atëherë personeli përgjigjet për trajtimin medicinal dhe përkujdesjen e fëmijës përderisa shërbi-mi social heton rastin. Nëse kontrollet mjekësore nuk e konfirmojnë shqetësi-min rreth neglizhencës apo lëndimit të fëmijut atëherë kjo do të shkruhet në zhurnal dhe do të njoftohet shërbimi social.

Nëse lajmërimi bëhet kur ti si i rritur je i sëmurë dhe personeli mendon se ti dhe fëmijët e tuaj keni nevojë për ndihmë, mjekimi ytë vazhdon si më parë. Shërbimi social do të kontaktoj ty dhe familjen tuaj për një takim të parë e pastaj do të vendoset nëse situata e fëmijës ka nevojë të hetohet dhe cilat masa ndihmëse janë të nevojshme. Ti dhe fëmijët e tuaj keni të drejtë të infor-moheni, këshilloheni dhe ndihmoheni nga personeli ku jeni duke u mjekuar.

Nga ligji i shërbimit social; nen 14 § 1:

Autoritete që në veprimtarinë e vet kanë kontakt me fëmijë dhe rini si dhe in-situcionet tjera mjekësore e shëndetësore e sociale janë të obliguar që menjëherë të lajmërojnë komisionin social nëse ata gjatë punës së vet fitojnë njohuri që një fëmijë është duke hequr keq.



Çka ndodh në rast lajmërimi?

Shërbimi social i zonës ku banon fëmija kontaktohet.

Shërbimi social mundohet gjithnjë për aq sa është e mundur të bëj hetimin e vet në bashkëpunim me fëmijën dhe familjen.

Kur lajmërimi arrinë në shërbimin social zakonisht thirret fëmija dhe prindërit në një takim. Aty vendoset nëse shërbimi i socialit do t'i filloj heti-met apo jo. Nganjëherë personi që e ka bërë lajmërimin merr pjesë në takim.

Nëse fëmija apo prindi janë të shtruar në spital atëherë nëpunësi i socialit vjen në repart për kontakt me ty si kujdestar fëmije dhe për të marrë informacione nga mjekët dhe personeli.

Nëse shërbimi social fillon një hetim ata zakonisht marrin kontakt me të tjerë, p.sh. BVC, parashkollë dhe shkollë, për të krijuar një përshtypje të plotë.

Në rast nevojë shërbimi social e thërret një mbledhje konsultative me autoritete përkatëse.

Një hetim zgjatë më së shumti katër muaj. Nga hetimi del se për çfarë ndihme ka nevojë fëmija dhe familja e tij ose nëse fëmija ka nevojë për mbrojtje. Rezultati i hetimit i komunikohet shëndetësisë nëse prindërit e japin pëlqimin e vet.

Region Skåne
291 89 Kristianstad
044-309 30 00
Skane.se

